

02

BULETINI I RIMËKËMBJES

Janar 2021

**PËR
BULETININ - 2**

**ÇKA ËSHTË RENTA MINERARE
DHE KUSH ËSHTË I OBLIGUAR TA PAGUAJË
ATË? - 2**

SA ËSHTË VLERA E RENTËS MINERARE? - 3

**ÇKA PARASHEH LIGJI
PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE PËR RENTËN
MINERARE DHE SI DO TË NDIKOJNË MASAT E
NDËRMARRA NGA KY LIGJ? - 4**

INKASIMI - 5

**INTERVISTË
EKSKLUZIVE ME KPMM**

PËR BULETININ

Qëllimi kryesor i Buletinit të Rimëkëmbjes është që në baza mujore të shpalos dhe ofrojë informata të përgjithshme tek publiku i gjerë rreth masave të ndërmarra nga institucionet e Republikës së Kosovës sa i përket rimëkëmbjes ekonomike. Këto masa janë inicuar me qëllim të mundësimit të rimëkëmbjes ekonomike në vend, pas pasojave të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Përveç se të informojë qytetarët rreth masave të rimëkëmbjes, ky buletin synon që të paraqet nivelin e zbatimit të masave krahas inkurajimit të hisedarëve drejt monitorimit të zbatimit të tyre.

Ky edicioni i buletinit shtjellon temën e rentës minerare, konkretisht fokusohet tek subjektet të cilat janë të obliguara ta paguajnë atë dhe artikujt e Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike dedikuar për këtë rentë, si dhe benefitet dhe pasojat e masave të ndërmarra nga po i njëjti ligj.

ÇKA ËSHTË RENTA MINERARE DHE KUSH ËSHTË I OBLIGUAR TA PAGUAJË ATË?

Renta minerare, apo *tantiema*, paraqet paratë e paguara në intervale të rregullta nga operatori i minierës tek shteti duke u bazuar në vlerën e mineralit. Duke ditur se mineralet në Kosovë janë pronë e shtetit, atëherë konsiderohet se renta minerare është pasuri shtetërore, përkatësisht përbën një pasuri publike dhe duhet të jetë pjesë e buxhetit të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Andaj, çdo ndërmarrje që shfrytëzon resurset minerale duhet t'i paguaj shtetit kompensim mbi shfrytëzimin e këtyre resurseve.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) është organi përgjegjës për vlerësimin dhe arkëtimin e rentave minerare. KPMM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-158, me aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me këtë ligj dhe Strategjinë Minerare.

**BULETINI I
RIMËKËMBJES
REALIZOHET SI
PJESË E PROJEKTIT
“BAROMETRI I
RIMËKËMBJES – PËR
TRANSPARENCË
DHE
LLOGARIDHËNIE”
MBËSHTETUR NGA
FONDACIONI I
KOSOVËS PËR
SHOQËRI TË HAPUR
(KFOS).**

**ÇDO NDËRMARRJE QË
SHFRYTËZON RESURSET
MINERALE DUHET T’I
PAGUAJ SHTETIT
KOMPENSIM MBI
SHFRYTËZIMIN E KËTYRE
RESURSEVE.**

SA ËSHTË VLERA E RENTËS MINERARE?



Sipas praktikave të ndryshme ndërkombëtare, renta minerare përcaktohet me përqindje të atyre mineraleve të radhitura në tregjet botërore të bursave. Çmimi i kësaj rente mund të ndryshojë varësisht nga çmimi në bursa. Por, ndryshe nga vende të shumta të botës, çmimi i rentës në vendin tonë është fiks. Edhe pse shkalla e rentës minerare aktuale në Kosovë për mineralet kryesore është dukshëm më e ulët se në shumicën e shteteve në botë, kur krahasohet me vendet e rajonit mund të themi se është përafërsisht e njëjtë.

Me 25 maj 2012, Kuvendi ka miratuar vendimin Nr. 04-V-380 [1] për pagesën e rentës minerare sipas lëndëve minerale dhe që atëherë kjo listë për pagesa të rentës nuk është ndryshuar. Në tabelën e paraqitur më poshtë mund të shihni vlerat e llogaritjes që duhet paguar si rentë minerare për disa nga resurset kryesore të Kosovës.

	Grupi i lëndës minerale	Lënda minerale	Njësia (t, m ³)	Renta Minerare	
				%	€/t
1.	Mineralet energjetike	Qymyri (Linjiti)	t		3.00 €
2.	Mineralet metalore	Argjendi	kg	5.00%	
3.		Hekuri (Fe)	t	4.50%	
4.		Nikeli (Ni)	t	4.50%	
5.	Gur gjysmë të çmuar	Opal	kg	4.00%	
6.	Uji mineral	Uji mineral	m ³	2.00%	

Tabela 1. Lista e Rentës Minerare

[1] Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2012). Vendim Nr. 04-V-380. E qasshme në: https://mzhe-ks.net/repository/docs/Vendimi_-_Lista_e_Rentes_Minerales.pdf


ÇKA PARASHEH LIGJI PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE PËR RENTËN MINERARE DHE SI DO TË NDIKOJNË MASAT E NDËRMARRA NGA KY LIGJ?

Në bazë të Nenit 14 të Ligjit Nr.07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID 19 “lirohen nga pagesa e rentës minerare prej datës 1 janar 2021 deri më 31 maj 2021 të gjitha subjektet që obligohen ta paguajnë këtë rentë”[2].

Vlen të theksohet se KPMM pas miratimit të kësaj Pakoje, ka bërë plotësim/ndryshimin e këtij vendimi duke qartësuar që subjektet, në këtë rast ndërmarrjet, do të lirohen nga pagesa e rentës minerare vetëm për sasinë e planifikuar sipas Projektit të Shfrytëzimit (planifikimi vjetor), që shpërndahet në baza mujore[3].

Dy nga disa përfituesit e kësaj mase janë:

1. **KEK**, e cila ndërmarrje duke u bazuar në inkasimin nga vitet e kaluara përfiton përafërsisht **10,500.000.00 EUR** nga masat e Pakos së Rimëkëmbjes.
2. **NewCo Ferronikeli Complex L.L.C**, e cila ndërmarrje duke u bazuar në inkasimin nga vitet e kaluara përfiton përafërsisht **700,000.000 EUR** nga masat e Pakos së Rimëkëmbjes.



Grafika 1. Inkasimi i rentës minerare në periudhën 2016-2020

[2] Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2020). Ligji Nr. 07/L-016 Për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35478>

[3] Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. (2021). Vendim për lirim nga pagesa e rentës minerare. E qasshme në: https://kosovo-mining.org/wp-content/uploads/2021/01/Vendimi-01_2021-per-Lirim-nnga-Pagesa-e-Rentes-Minerare-shq.pdf

INKASIMI

Duke u bazuar në raportimet e KPMM-së, të hyrat më të mëdha të inkasimit të rentës minerare, sidomos gjatë 3 viteve të fundit, janë në gjashtë mujorin e parë të vitit. Pikërisht për këtë arsye në Ligjin për Rimëkëmbje lirimi nga obligimi për pagesë të rentës minerare nga subjektet e caktuara është bërë në gjashtë mujorin e parë të vitit.

Inkasimi i rentës minerare për 5 vitet e fundit

Gjatë vitit 2019, lëndë minerare të shfrytëzuar sipas kategorive janë:

Minerale Metalike Pb-Zn (204,079.00 ton), Ni-Co (305,012.48 ton), Minerale energjetike (linjit) 8,063,051.00 ton

Gjatë vitit 2018, lëndë minerare të shfrytëzuar sipas kategorive janë: Minerale Metalike Pb-Zn (173,243.96 ton), Ni-Co (431,630.06 ton), Minerale energjetike (linjit) 7,169,767.00 ton.

Gjatë vitit 2017 lëndë minerare, të shfrytëzuar sipas kategorive janë: Minerale Metalike Pb-Zn (216,798.50 ton), Ni-Co (624,557.87 ton), Minerale energjetike (linjit) 7,574,697.00 ton.

Gjatë vitit 2016 lëndë minerare, të shfrytëzuar sipas kategorive janë: Minerale Metalike Pb-Zn (251,405.00 ton), Fe-Ni (402,397.31ton), Minerale energjetike (linjit) 8,800,848.00ton, Minerale industriale (argjila) 256,481.83ton, Minerale ndërtimore 7,012,033.31m³.

Gjatë vitit 2015 lëndë minerare, të shfrytëzuar sipas kategorive janë: Minerale Metalike Pb-Zn (225,289.00 ton), Fe-Ni (651,918.51 ton), Minerale energjetike (linjit) 8,240,694.00 ton, Minerale industriale (argjila) 104,170.22 ton, Minerale ndërtimore 7,309,998.48 m³.

Përshkrimi	Inkasimi për vitin 2020	Inkasimi për vitin 2019	Inkasimi për vitin 2018	Inkasimi për vitin 2017	Inkasimi për vitin 2016
Renta Minerare	29,362,288.10	29,385,154.20	25,233,911.19	30,570,475.56	30,558,340.54

Tabela 2. Inkasimi i rentës minerare në 5 vitet e fundit

INTERVISTA EKSKLUZIVE: ME DREJTORIN E KPMM-SË, Z.RAMIZ KRASNIQI

Buletini i Rimëkëmbjes synon që me anë të intervistave ekskluzive të zhvilluara në përputhje me temën e buletinit do të sjell pikëpamjet e institucioneve kyçe të fushës. Në këtë edicion, për të pasur informacione sa më të sakta mbi rentën minerare dhe Pakon e Rimëkëmbjes, INDEP ka zhvilluar intervistë me drejtorin e KPMM, z.Ramiz Krasniqi.

Mbi efektet e heqjes së pagesës mbi rentën minerare

Gjatë intervistimit, z.Krasniqi është pyetur fillimisht se sa do të ndihmojë heqja e rentës minerare në rimëkëmbje ekonomike. Ai na shpjegon shkurtimisht se heqja e kësaj rente minerare nuk do të ketë impakt të madh në rimëkëmbjen ekonomike. Kjo për arsyen se lirimi nga pagesa e rentës minerare të subjekteve që janë të obliguara të paguajnë, zvogëlon të hyrat nga ato që ky institucion merr nga kjo rentë çdo vit. Arsye tjetër sipas z.Krasniqi se pse lirimi nga pagesa e rentës nuk ndikon në mënyrë drastike si masë për rimëkëmbjen ekonomike është se prodhimitaria e lëndëve minerale gjatë vitit 2020 nuk ka qenë më e vogël se në vitet paraprake. Kjo nënkupton se pandemia nuk ka pasur ndikim të madh, për të mos thënë fare, në këtë sektor shpjegon z.Krasniqi.

Më tutje drejtori i këtij institucioni na tregon se duke u bazuar në 3 vitet e fundit, të hyrat më të mëdha të rentës minerare, kanë qenë në 6 muajt e pare, përafërsisht për gjysmë milioni më shumë. Më tutje drejtuesi i KPMM shpjegoi se edhe pse të hyrat nga renta minerare janë më të mëdha në 6 muajt e parë të vitit dhe aktivitet më të madh të eksploatimit të resurseve ka kryesisht në këtë periudhë, heqja e rentës minerare për periudhën janar – maj nuk do të ndikojë shumë në punën e kompanive. Kjo për arsye se subjektet që do të lirohen nga renta nuk do të paguajnë më shumë ose më pak sesa që është parashikuar në planin e tyre vjetor.

Mbi vendimin e Qeverisë për masat e Pakos së Rimëkëmbjes

Duke qenë se KPMM është institucion i pavarur dhe i raporton vetëm Kuvendit, për propozimin e masave të tilla Qeveria duhet të konsultohet me KPMM-në para se ta hartojë një projektligj të tillë. Drejtori i këtij institucioni na tregon se KPMM nuk është konsultuar fare para hartimit të projektligjit, respektivisht masës për lirim nga pagesa e rentës minerare të subjekteve që janë të obliguara të paguajnë. Megjithatë, KPMM pas aprovimit të ligjit është konsultuar me Qeverinë dhe Kuvendin për nxjerrjen e Vendimit për lirim nga renta për të gjitha ndërmarrjet që posedojnë licenca të shfrytëzimit, vendim ky që është plotësim/ndryshim i vendimit të parë, dhe që është mjaftë i nevojshëm që KPMM ta vazhdojë punën e saj pa vështirësi të mëdha. Për fund, z.Krasniqi tregoi shkurtimisht se të hyrat e KPMM-së do të shkurtohen nga kjo masë e rimëkëmbjes. Sipas kalkulimeve të bëra deri më tash mbi 13 milion EUR të hyra do të jenë më pak në këtë 5 mujorësh.



Ky buletin është përgatitur me mbështetjen e
Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).
Pikëpamjet e shprehura në këtë buletin janë të INDEP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të
konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).